

## KANONI LETRAR KOMBËTAR THE NATIONAL LITERARY CANON

ZEQIRJA NEZIRI

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski”, Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi”, Shkup, MAQEDONI

Email: zeqirjaneziri@yahoo.com

**AKTET VI, 4: 469-477, 2013**

### PERMBLEDHJE

Në frymën e studimeve të sotme letrare kemi shtruar në diskutim dy çështje teorike të studimit të historisë së letërsisë shqiptare nga fillimet e deri në fund të shekullit XX, më konkretisht deri në vitet e '30-ta të shekullit XIX:

(1) njëra është çështja e disiplinave e nëndisiplinave shkencore që duhet të kihen parasysh kur hartohet kanoni letrar kombëtar;

(2) ndërkaq, çështja e dytë është në duhet të kemi një apo më shumë kanone letrare?

Kanoni letrar kombëtar, si e shpjegon teoria bashkëkohore e letërsisë nuk ka të bëjë vetëm me vlerat e dëshmuara të traditës letrare kombëtare, por është dukuri në të cilën marrin pjesë kritika letrare, botuesit dhe mësimdhënia e letërsisë, ndaj meriton edhe vëmendje kulturore – sociologjike.

Në të a.q. bashkësi kulturore demokratike mendohet për ndërtimin e shumësisë së kanoneve, të cilët vazhdimisht alternohen. Në këtë kontekst synohet të jepet një ndihmesë për historishkrimin e letërsisë shqip(tar)e.

**Fjalë kyçe:** kanoni letrar kombëtar, mësimdhënie, botues, kritikë letrare.

### SUMMARY

In the spirit of literary studies today we have raised two issues in the discussion of the theoretical study of literature Albanian history from the beginning to the end of the twentieth century, specifically in the '30s until the nineteenth century:

(1) one is the issue of disciplines and that of sub-disciplines of scientific sights, which should be taken into account when designing national literary canon;

(2) however, the second issue is that we need to have one or more literary canons?

National literary canon, as contemporary literary theory explains not only deals with the proven values of national literary tradition, but is a phenomenon in which literary criticism participate, publishers and the teaching of literature, and that's why it deserves the attention of sociological culture. In what is called cultural communities it is thought to build democratic plurality of canons, who constantly are alternating. In this context is intended to provide a contribution to the literature of albanian historio-graphy

**Key words:** national literary canon, teaching, publishing, literary critique.

---

### HYRJE

Në këtë kumtesë, në frymën e studimeve të sotme letrare kemi shtruar në diskutim disa çështje teorike dhe praktike të studimit të letërsisë shqiptare të periudhës së Pararilindjes, të Rilindjes e

të Pasrilindjes Kombëtare Shqiptare deri në gjysmën e dytë të shekullit XX, që kanë të bëjnë me probleme të programimit të saj në sistemet shkollore; mandej çështje metodologjike të studimit, mësimdhënies dhe jetësimit të meto-

dologjive të ndryshme nëpër librat mësimore pa-rauniversitare dhe universitare, si dhe çështje të *sistemimit të saj* brenda letërsisë kombëtare e të harmozimit të saj me letërsinë evropëndimore. Artikulli, në këtë mënyrë shtron në diskutim dhe rreh çështje të mundësisë së ndërtimit të kanonit letrar kombëtar (në të cilin do të përfshiheshin krijuesit reprezentativë me veprat e tyre shembullore të letërsisë kombëtare, të krijuara në kohë dhe hapësira të ndryshme gjeografike), mbi të cilin do të hartoheshin programet mësimore të letërsisë kombëtare për t'u vënë në praktikë në mjedise të ndryshme kulturore, shoqërore politike e letrare. Ndaj ai sjell një ndihmesë modeste për historishkrimin dhe mësimdhënien e historisë së letërsisë shqip(tar)e nëpër shkolla të niveleve të ndryshme të arsimit fil-lor, të mesëm e universitar.

### 1. Afirmimi funksional i mbamendjes kulturore letrare kombëtare

Në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar një grup studiuesish gjermanë të nxitur, në njërën anë, nga shkolla e Torontos, në krye me Eric Havelodkun dhe Marshal McLuhanin, që merreshin me historinë e mediave; dhe, në anën tjetër, nga filozofia poststrukturaliste franceze, e cila hulumtonte madialitetin e shkrimit; pastaj të fenomenologjisë dhe të teorisë së recepcionit erdhi në një përkufizim të ri të tekstit letrar. Sipas tyre teksti letrar është “shprehje e re e përkapjes në kuadër të situatës së tendosur komunikuese”. Komunikimi artistik i shkruar, në formë të tekstit të shkruar, sipas tyre për dallim nga komunikimi artistik gojor, nuk përjetohet vetëm në momentin e paraqitjes, por mund të përkapet edhe pas tij, kështu që, ai, është në gjendje të ndërtojë një urë komunikimi midis kohëve të ndryshme dhe mundëson kontakt me të kaluarën e të tanishmen.

Teoria e tyre i kundërvihet “*sistemimit ahistorik*”, atëherë paradigme dominante strukturaliste. Nga ana tjetër, përpjekjet e këtij grupi ishin që letërsinë ta kuptojmë në bashkëmarrëdhënie me sistemin e tërësishëm të prodhimit kulturor letrar. Komunikimi i letërsisë, kështu del i barabartë me termin e shkrimit, të shkrimit në kuptim

të “kulturës së shkruar, në të gjitha format e kushtëzimit të tij shoqëror”.

Mbamendja kulturore i jep një kulture strukturën e komunikimit artistik me recipientin kombëtar dhe jashtëkombëtar. Me të përcaktohet “horizonti” brenda të cilit ndonjë bashkësi bëhet e njohur për të tjerat dhe, që është më e rëndësishme, brenda saj, pjesëtarët e bashkësisë, si të tillë mund të njihen nga të tjerët. Formën e saj, gjithmonë, e mendon një numër i vogël i pjesëtarëve të elitës intelektuale, e cila pastaj, pasi ta ketë kapur rrjedhën, në mënyrë “demokratike”, mund ta riorientojë edhe faktorin e saj themelor mbi të cilin është krijuar bazamenti i formulimit të identitetit artistik kulturor.

Letërsia, sipas teorisë së mbamendjes kulturore, konsiderohet mbamendje funksionale. Aide dhe Jan Assmann mendojnë se kujtesa letrare e sheh të kaluarën ndryshe dhe është në pozitë të kundërt me kujtesën narrative zyrtare. Aide dëshmon se identitetet kulturore nuk janë krijuar nga zoti, se mbështeten në seleksionim, censurë dhe përjashtim. Dialektikisht është e lidhur me mbamendjen funksionale: në ndonjë moment, mund edhe të jetë pjesë e saj. Megjithatë, teksti letrar meqë *kujton* të harruarën, meqë *kujtohet* në të tanishmen, meqë *përkujtohet ndryshe nga ne*, pamundëson stabilizimin e mbamendjes kulturore dhe tjetërsimin e saj në hapësirë statike, si e dëshiron çdo pushtet. Ajo këtë hapësirë e rifirmon, e riformon dhe e zgjeron në mënyrë të pandërprerë, duke ofruar mundësi që identitetin kulturor ta përjetojmë në dinamikën e tij – vetëm në përtëritjen e tij të pandërprerë.

Megjithatë, më e rëndësishme është të lejojmë që teksti në diçka të na mësojë si të gjallërojmë me përvojën personale, që tezat për të t'i marrim seriozisht si hipoteza rivale të parimeve tona vetjake për botën. Gadameri këtë proces e quante “*horizont të shkrirjes*”. Nga ana tjetër, shkenca e letërsisë na mëson se interpretimi ynë i ndonjë teksti, sado që ta konsiderojmë shkencërisht të mbështetur dhe të fortë, kurrë *nuk duhet të konsiderohet si interpretim i vetëm dhe i fundit*. Pikërisht shfrytëzimi i përvojës personale i ka dhënë kuptimin (tonë) të tekstit të dikurshëm. Gjithmonë është e mundshme që dikush me

përvojën tjetër, të tijën ta zbulojë kuptimin që prej nesh ka mundur të jetë i anashkaluar ose i shmangur. Kështu, duke u marrë me kuptimin e ndonjë teksti veprojmë në mënyrë të njëjtë: analiza jonë mbetet vetëm hipoteza jonë për kuptimin e ndonjë teksti.

## **2. Laryshia e pikëpamjeve metodologjike nuk duhet të kalojë në anakronizëm**

Kjo mundësi e re e komunikimit me të kaluarën letrare, në kushtet e “komunikimit të nderë”, padyshim ka kushtëzuar mënyrën, sipas të cilës sot, kulturat e shkruara, nisin ta vlerësojnë traditën e tyre. Studiuesit e historisë së letërsisë shpeshherë i kthehen problemit të sistemimit, segmentimit dhe studimit të lëndës së letërsisë, sepse me rimarrjen e sërishme dëshiron t’i përplojë të përbushë lëshimet e zbrazëtirat e bëra si në rrafshin metodologjik, ashtu edhe në atë teorik të interpretimit të procesit krijues. Kjo bëhet me të vetmin qëllim që të përpunohen gjykimet e mëhershme dhe të freskohen me njohuri të reja të studimit të sotëm teorik.

Në trajtimet historike letrare shqiptare sot është pranuar pikëpamja se letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare i paraprin një periudhë e gjatë letrare, e cila paraqet nismën dhe ecurinë e veçantë, paraqet bazmentin vetjak e të pavarur të funksionimit të prodhimit letrar kombëtar në historinë e letërsisë kombëtare. Letërsia shqiptare në përgjithësi, sot, studiohet në shumë qendra universitare shqiptare, evropiane dhe botërore, njësoj si mësohet e studiohet nëpër shkolla fillore e të mesme, në trojet etnike dhe në diasporë, sidomos te arbëreshët e Italisë.

Në trojet etnike: në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni studiohet sipas tre sistemeve të arsimi që parashohin aktet normative të këtyre shteteve. Kur këtyre tri sistemeve i shtohen edhe ato të Malit të Zi e të Kosovës Lindore, shohim se vetëm në trojet etnike praktikisht janë në zbatim pesë sisteme shkollimi, ndaj edhe hartohen pesë lloje librash mësimore, pra edhe ndërtohen pesë parime të hartimit të planprogrameve e të teksteve mësimore. Kjo nënkupton se historia e letërsisë shqiptare, përveç problemeve të brendshme të studimit vetjak brendakombëtar, si

letërsi kombëtare e veçantë nga letërsitë e tjera fqinje dhe më tej evropiane, para vetes, ka edhe problemin e përfshirjes së prodhimit letrar shqiptar në rrjedhat e përgjithshme letrare rajonale e botërore, mandej të përafrimit të pikëpamjeve shumë herë tepër të largëta, bile edhe të kundërta të studiuesve. Pikëpamje këto që sa janë pasojë e zotërimit të njëanshëm të lëndës, aftësisë ose mungesës së saj për përvëçimin e tipareve dalluese, metodologjive të ndryshme studimore (një pjesë e të cilave ka herë kanë dalë nga përdorimi, për të mos thënë janë të demoduara), po aq edhe të kryeneçësisë së ndonjë studiuesi.

Nga një krahasim i planprogrameve mësimore të lëndës së letërsisë shqiptare në të gjitha universitetet e shkollat e mesme dëshmohej se sa i përket planeve të përfshirjes së lëndës dhe të shtrirjes së saj nuk ka ndonjë dallim shumë të madh, edhe pse edhe në këtë drejtim ka hapësirë për diskutim. Ajo përpunohet, me një numër të përafërt orësh 4 ose 6 në javë për çdo vit.

Përkundër përafrimit kuantitativ programor dhe shtrirjes së lëndës mbetet e paqartë dhe çështje më vete metodologjia e punës, jo në kuptimin e metodologjisë së punës me studentët e nxënësit, por në kontekst të studimit të lëndës. Rëndom metoda e punës me studentët e nxënësit, kudo është ajo e bashkëbisedës, e interaksionit, pra kreative. Mirëpo, në këto planprograme mësimore, as për transparencë dhe as për krenari, askund nuk jepet metoda studimore e bartësit të lëndës: a është kjo metoda pozitiviste, sociologjike, historike, apo të trija bashkë; ose ajo filologjike tekstuale; ndodh të jetë edhe metoda e teorisë së mbamendjes kulturore ose e teorisë së mbijetojave kulturore.

Laryshia e planprogrameve dhe e librave nuk do të thotë se e varfëron interpretimin dhe studimin e prodhimit letrar dhe se është në dëm të tij, përkundrazi e begaton dhe e rrit fondin e hartuesve të librave dhe kështu ndihmon zbulimin, gjetjen dhe stabilizimin e mendimit teorik letrar shqiptar. Gjithçka do të ishte në rregull sikur të mos kishte një por, sikur një pjesë e mirë e këtyre pikëpamjeve të mos ishin kaq shumë të largëta midis tyre sa që jo vetëm qëndrojnë në pozita të

ndryshme, por edhe të kundërta, bile disa edhe të jenë jehonë e disiplinave shkencore shumë të largëta e të harruara të studimit të letërsisë. Që këtu edhe tepria e theksueshmërisë së *subjektit* studiuës, në emër të *intersubjetivizmit* metodologjik shumë lehtë kalon në *anakronizëm* e *anarkizëm*.

### 3. Kanoni letrar kombëtar dhe kanoni letrar ndërkombëtar (botëror)

Kanoni letrar kombëtar, si e shpjegon teoria bashkëkohore e letërsisë nuk ka të bëjë vetëm me vlerat e dëshmuara të traditës letrare kombëtare, të cilat edhe në kushtet e kulturave të zhvilluara letrare rrallë sërish vendosen, sprovoen dhe ndryshe interpretohen, por është dukuri në të cilën marrin pjesë kritika letrare, botuesit dhe mësimdhënia e letërsisë, ndaj edhe shpesh meriton vëmendje kulturore – sociologjike. Zakonisht autorët e krijimit të veprave letrare me vlera të mëdha letrare për historinë letrare të kombit i quajmë klasikë, tekstet e këtyra klasike, që do të thotë janë shembullorë, të klasit të parë, të përsosura. Rrjedhat e llojlloshme të debatit kanë sjellë dilemën të jetë një kanoni apo disa kanone letrare kkombëtare. Me rastin e dytë lëkundet bindja tradicionale sipas së cilës në ndonjë bashkësi kulturore është i mundshëm vetëm një kanon normativ, i cili detyrimisht është edhe krijues kulturor. Në të a.q. bashkësi kulturore demokratike mendohet për ndërtimin e shumësisë së kanoneve, të cilët vazhdimisht alternohen, ndërkaq normativiteti i kanonit sundues përpiket jo vetëm ta relativizojë, por edhe ta sjellë në pikëpyetje dhe në fund ta shmangë nga duart e qendrës akademike të forcës. Për historinë e letërsisë shqiptare, gjithsesi procesi i kanonizimit është njëra prej procedurave më interesante, sepse shpesh pavetëdijshëm dhe pamjaftueshëm pyetemi për të gjitha arsyt ose parimet e procedurave të kanonizimit të ndonjë autori, përkatësisht të ndonjë teksti.

Thënë më thjeshtë, kush është i thirrur të vendosë, kush dhe në bazë të çkafit e merr të drejtën të zgjedhë dhe ta bëjë seleksionimin e vlerave, në emër të cilave interesa dhe me çfarë qëllimi e bën këtë dhe kush e si i ruan përfitimet dhe të

drejtën ekskluzive ta përfaqësojë, përfshijë dhe përjashtojë (?!); a mund t'u bëhet vërejtje autoriteteve të këtyra se pjesë përbërëse të procedurave të këtyra është mbajtja llogari vetëm për parimet subjektive dhe jo për besueshmërinë e tyre nëpërmjet pyetjeve kritike të vendit institucional prej të cilit flasin?!

Termi kanon fillimisht, në greqisht ka pasur kuptimin 'rregull', 'rregullim' (gr. *kanōn*), pastaj ka marrë kuptimin e përmbledhjes së 'të gjitha librave biblikë, të cilët Kisha i njeh si të hyjnizuar dhe i konsideron norma të besimit' (Aniç 2003: 548), që në kohën e sotme ta shenjojë tërësinë e zgjedhur akademike të veprave letrare, të cilat janë pjesë e rëndësishme e kulturës letrare njerëzore edhe kombëtare edhe ndërkombëtare. Për shkak të zgjedhjes joobjektive, në teorinë e letërsisë kanë ekzistuar edhe shumë kritika dhe revidime të kanonit.

*Autori* dhe *vepra* lidhen me termin e autorit kah fundi i shekullit të 18 – të, kur stabilizohen normat e pronësisë së tregut letrar. Është problematike të përcaktohet kanoni i veprave që hyjnë në letërsinë botërore. Historia e letërsisë është dashur të mbështetet në përvojën e hulumtimeve të letërsisë, e cila i ka paraprirë të shkruarës, pra të *letërsisë gojore*. Fuqia 'magjike' e gjuhës është një rekonstruim (Solar 2003: 18) i mundshëm i letërsisë primitive, por nga ana tjetër ajo paraqet ndonjë lloj të lojës me fjalën, me gjuhën (Solar 2003: 21). Burimet e mitologjisë janë në gojëdhënë, ndërkaq mitologjia e themeluar në kulturën gojore i paraprin letërsisë së shkruar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës (Solar 2003: 23). Rol të rëndësishëm në këtë rindërtim kanë pasur mitologjia asiro – babilonase, egjiptiane, pastaj helene, indase, kineze, romake dhe përgjithësisht mitologjia indoevropiane. Aty janë *paratregimet* dhe *parapërrallat*. Gjuha letrare është emancipuar prej çfarëd konteksti 'natyror', tradicional dhe stilor, ndërkaq kanonizimi i cilësisë së 'letrares' fillimisht përhapet duke përfshirë letërsinë e lashtë indase e perse, pastaj letërsinë mesjetare evropiane dhe letërsinë gojore të shumë popujve (Biti 1997: 66).

#### 4. Autorët me vlera mesatare bartës të kërkesave teorike të periudhave letrare

Metodologjia e historisë së letërsisë kryesisht huazon nga paradigma ekzistuese e historisë së letërsisë idenë e opusit / autorit reprezentativ, me të cilën shpesh dhe, në mënyrë shumë të thjeshtë i tregon periudhat në rrjedhën sukcesive ose zëvendësuese. Qyshkur është vërejtur se shkrimtarët me vlera të mesme më mirë e ilustronjë ndonjë epokë letrare, ndonjë formacion stilor ose drejtim letrar, poetikën e periudhës, por megjithatë historianët e letërsisë “zhvillimin” e ndonjë letërsie më mirë e paraqesin me tekstet kanonike (shembuj De Rada dhe Santori). Edhe pse të gjithë jemi të vetëdijshëm se tekstet kanonike, tekstet e klasikëve të ndonjë periudhe të letërsisë kombëtare, tejkalojnë kufijtë e periudhës, si dhe kufijtë e ndonjë letërsie, bëhen tejkohorë e gjithëkohorë dhe me përkthimin në gjuhë të ndryshme, bëhen universalë. Thënë ndryshe, bëhen të rëndësishëm edhe për letërsitë e tjera kombëtare, përkatësisht kulturat e ndonjë gjuhe tjetër kombëtare.

Me rëndësi themelore është problemi metodologjik i pasqyrimin të marrëdhënieve të kanonit dhe të historisë së letërsisë- vallë a mund të tregohet zëvendësimi i periudhave me tekstet reprezentative dhe me autorët, kur ato, si tekste kanonike janë tekste transtemporale dhe transkulturore? Përgjigja e përkohshme mund të jetë: po, mundet, nëse procesi i kanonizimit përfshin shumë periudha dhe shumë histori kombëtare të letërsisë, nëse teksti i autorit i është përvjedhur idealit të paradigmes nëntëmbëdhjetëshekullore të historisë së letërsisë kombëtare. Për këtë më mirë flasin përpjekjet e krijimit retroaktiv të teksteve kanonike të letërsisë së re, si dhe gjykimet e parakohshme historikeletrare të shkrimtarëve të letërsisë bashkëkohëse, në të cilat historianët e letërsisë tregohen si kritikë letrarë, ndërkaq kritikët letrarë impresionojnë me gjykimet nga pozitativ e autoritetit konservativ akademik.

#### 5. Diasistemi gjuhësor shprehje e ideosistemit letrar kombëtar

Nga ky aspekt debati për kanonin, në kontekst të letërsisë së sotme shqiptare nuk mund të jetë i kufizuar vetëm në aspektin kombëtar, përkatësisht i kushtëzuar me paradigmen nëntëmbëdhjetëshekullore të historisë së letërsisë, në mjedisin tonë, mjerisht të përtëritur edhe në kohën tonë, në fillimshkullin e njëzetënjëtë. Në rastin më të vogël është i domosdoshëm kuptimi i dyfishtë i proceseve karakteristike letrare dhe ndërletrare për komunikimin letrar shqiptar. Pranë pikëpamjeve shpesh të rrudhura, reduktuese të historisë së letërsisë kombëtare, në frymën qyshkur të shprehur të kërkesës për nevojën e ndryshimit radikal të paradigmes së historisë së letërsisë, është e nevojshme për shumë procese historike letrare ‘të tepërta’ të ruhet horizonti i tërësisë gjuhësore dhe i përvojës kulturore të hapësirës së caktuar komunikuese.

Qyshkur është vërtetuar se arsyeja më e rëndësishme ‘natyrore’ e tërësisë së letërsisë kombëtare është ‘uniteti integral i materialit gjuhësor’. Prandaj, për këtë arsye letërsia e ‘diasistemit gjuhësor’ shqiptar duhet të mësohet në paradigmen e historisë së letërsisë kombëtare, si tërësi relativisht unike. Se kjo nuk bëhet, por letërsia kombëtare paraqitet duke pasur parasysh imazhin (ideologjinë) e kulturës kombëtare, është fakt përgjithësisht i ditur, por kjo nuk do të thotë se duhet të hiqet dorë nga përpjekja për ndryshimin e paradigmes së historisë së letërsisë, kur vetë rrethanat, më sakt ‘gjendja në terrenin letrar’ dhe në materialin letrar forcohet në të (përdorimi i gjallë i formave krahinore ose dialektore gjuhësore të disa shkrimtarëve shqiptarë\_qarku i Shkodrës, ose gegërishtja në tërësi, përballë tyre shkrimtarët e arealit gjuhësor tosk të krahinave të ndryshme, ose këmbëngulja e arbëreshëve të Italisë të vazhdojnë të shkruajnë në të folmen e tyre). Letërsia shqiptare vetëm në dukje ka argumenta filologjikë për heqje dorë nga historia e letërsisë të mbështetur në unitetin e materialit gjuhësor ose si dëshirohet të thuhet në ‘identitetin gjuhësor’, sepse ai vetë ‘shkrihet’ në letërsinë ‘kryesore’ dhe në dy a tri ‘nënletërsi’, të

cilat përgjithësisht gati kanë kontinuitet njëjtë e të pandërprerë historik.

## **6. Kanoni letrar shqiptar deri te Rilindja Kombëtare**

Po ashtu është miratuar pikëpamja, jo vetëm e studiuesve shqiptarë të letërsisë së tyre, por dhe e studiuesve të letërsive të tjera evropiane se deri në periudhën e Rilindjes Kombëtare, duke përfshirë periudhën e Humanizmit të begatshëm me autorë e vepra, letërsia shqiptare si dhe ato evropere, në komunikim me lexuesin kishte rol shoqëruar, dytësor. Edhe pse arti letrar edhe përgjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare vazhdon të jetë i angazhuar, por tani angazhimi i tij *kombëtarisht* është shumë më i avancuar, duke iu nënshtruar formimit dhe afirmimit të vetëdijes e të ndërgjegjes kombëtare dhe i shërben ndërtimit të letërsisë, të gjuhës, të shkollës e të dijes kombëtare.

Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dëshmon përfshirjen e shqiptarëve në rrjedhat e përgjithshme letrare evropiane dhe ndërkombëtare, që nënkupton dhe ndihmesën e tyre vetjake në proceset e përgjithshme letrare botërore.

### **6. 1. Siletërsia dhe letërsia kombëtare shqiptare**

Fazën nismëtare të letërsisë shqiptare në të gjitha programet mësimore dhe në librat shkollorë ne akoma e nisim me dokumentet dhe dëshmitë për shkrimin e shqipes. Kjo periudhë, në të gjitha letërsitë evropiane, quhet **letërsi e Mesjetës** dhe karakterizohet si *letërsi e mbishkrimeve* dhe *e kodikëve*, pra është kulturë letrare ose *siletërsi e letërsi* e skalitur në gurë e drunj ose është ruajtur në dorëshkrime nëpër kodikë, kurse letërsitë e mirëfillta gjëllinë e frymojnë lirshëm në tipin e *letërsisë gojore*, sepse zbulimi i shtypshkronjës, pra edhe paraqitja e librit të botuar i atribuohet dhe është arritje epokale e Humanizmit e Rilindjes Evropiane, kur edhe nisin të ndërtohen letërsitë kombëtare evropiane, në gjuhët kombëtare.

Edhe në trojet shqiptare kanë ekzistuar kodikë, si ai i *Purpurtë* (shekulli 6) apo ai i *Artë* (shekulli 9) të Beratit, apo *Katërrungjillori i Vlorës* i shekullit të 10 (të gjithë në greqisht) ose këta të Durrësit, Lezhës, Shkodrës, Tivarit e Ulqinit të shekujve 10

– 12 (në latinisht), pra në gjuhët e shkencës dhe të kulturës së shkruar të atëherëshme evropiane. Brenda këtyre kodikëve janë përfshirë edhe Statuti i Shkodrës ose ai i Drishtit, apo Lezhës, Ulqinit si dhe dëshmitë dhe dokumentat për popullin shqiptar dhe për gjuhën e kulturën e tij të shkruar. Është një periudhë e *kulturës shkrimore*, e cila sipas *teorisë së mbamendjes kulturore* bën pjesë në traditën e përgjithshme kulturore shkrimore të protoshqiptarëve. Domethënë, periudhën nismëtare të letërsisë shqiptare do ta përbënin, në njërin anë, prodhimi letrar dhe siletrar i truallit shqiptar në gjuhët latine dhe greke, në formë të mbishkrimeve e të kodikëve; dhe, në anën tjetër, shkrimet e para siletrare në gjuhën shqipe, të njohura si dokumenta të shkrimit të shqipes. Por nuk duhet harruar (dhe këtë, tanimë nuk është e dyshimtë, e ka vërtetuar shkenca albanologjike) se në periudhën e Mesjetës, pra në atë agrafike të letërsisë shqiptare ka funksionuar në mënyrë paralele, është ndërtuar e konsoliduar dhe gjallërisht ka vepruar *eposi heroik shqiptar* (dhe llojet e tjera të *letërsisë gojore shqiptare* me të gjitha veçantitë e veta), i cili ka qenë i kënduar në gjuhën shqipe dhe që dëshmon për një nivel jashtëzakonisht të lartë të formimit kulturor e letrar të protoshqiptarëve mesjetarë.

### **6. 2. Humanizmi shqiptar koherent me humanizmin evropian**

Menjëherë pas saj vjen periudha e Humanizmit të ndritur Shqiptar, e cila, hiç periudhat e Pasrilindjes Kombëtare, nuk është e vetmja periudhë letrare koherente dhe simetrike me letërsitë evropiane të kësaj pjese të letërsisë shqiptare. Humanizmi, si dhe Mesjeta paraprake, afirmonte evropocizmin, sepse gjuhë e afirmimit kulturor e shkencor dhe politik e ideologjik ishte latinishtja, në Perëndim ose greqishtja në Lindje. Gjuhët kombëtare në kulturën e shkruar, pra edhe në letërsi paraqiten në fund të saj, në periudhën e Rilindjes Evropiane, kur edhe formohen e nisin të konsolidohen letërsitë kombëtare angleze, franceze, gjermane, italiane, spanjolle.

### 6. 3. 0. A ka letërsia shqip(tar)e elemente përafruese me letërsisë evropiane në prag të Rilindjes Kombëtare?

Pas këtyre dy periudhave pason një heshtje e gjatë, një lloj tërheqje brenda kompleksit kombëtar dhe krejt periudha pasuese deri te Rilindja Kombëtare edhe pse njeh dy etapa, konsiderohet si një etapë dhe e vetme. Në aspektin teorik letrar më e diskutueshme është ajo e fundshekullit të 17 deri në fillimshkullin e 19, sepse ndahet duke pasur pikënisje ose *matjen mekanike të kohës* (parim shkencor i disiplinës së historisë), *krahinën* (të Veriut e të Jugut sipas parimit gjeografik të klasifikimit të letërsisë në sinkroni), ose *dialektin e nëndialektin* (gege dhe toske sipas kriterit gjuhësor në sinkroni); ose *qarqet kulturore* (parim i periodizimit të letërsisë sipas metodës shpirtërore – historike të W. Diltajit e pranishme në shkencën gjermane të viteve të njëzeta të shekullit të kaluar); dhe më keq, segmentimi i saj bëhet sipas *kriterit ideologjik universal* (katolike ose ortodokse e myslimane); ose edhe kombinimi i tyre: *katolike - veriore – gege, gjegjesisht ortodokse – jugore – toske*. Të gjitha këto pikëpamje të studiuesve shqiptarë janë të pranishme në diasistemimin e pjesës së letërsisë shqipe midis Humanizmit të shquar Shqiptar dhe Rilindjes së zhvilluar Kombëtare Shqiptare, pra të periudhës nga fundshekulli XVII deri në vitet '30 të shekullit 19. Kjo pastaj shkakton disproporcion në përafrimin e letërsisë shqipe me atë botërore në tekstet shkollore, sidomos në ato të shkollave të mesme, ku vërehet një asimetri midis letërsisë shqipe dhe asaj botërore.

Gjykuar nga përvoja dhe arritjet e studimeve të sotme në fushën e letërsisë botërore zbatimi praktik i tyre në letërsinë shqipe nga Humanizmi deri te Rilindja do të ishte i lehtë dhe i mundshëm, jo vetëm në kuptimin e bartjes mekanike të tyre në truallin shqiptar, por edhe në kuptimin e zbulimit të elementëve përafrues të letërsisë shqipe me letërsinë evropërendimore.

#### 6. 3. 1. Letërsia e Barokut religjioz shqiptar

Në kontekst të përafrimit të periudhës së letërsisë shqipe nga gjysma e dytë e shekullit 16 deri në fundshekullin e 17 – të me **Barokun letrar**

**religjioz** evropian përpjekje të suksesshme kanë bërë: N. Resuli dhe I. Rugova për *Çetën* e Bogdanit dhe ne (Z. Neziri) me studimet mbi *Mësharin* e Buzukut dhe mbi vjershat e Budit e të autorëve të tjerë.

#### 6. 3. 2. Letërsia e Iluminizmit shqiptar

Ngjashëm kanë vepruar Masar Stavileci, Alfred Uçi dhe studiuesit arbëreshë në përafrimin e voskopjarëve e të prodhimit letrar arbëresh me Iluminizmin e fundshekullit XVII, shekullin XVIII në tërësi dhe fillimshkullin e 19 – të, i cili në letërsinë evropiane (bashkë me Utopizmin Social, Sentimentalizmin, Racionalizmin) përfshihet nën termin e **Klasicizmit**. Nuk duhet harruar se në këtë periudhë të letërsisë shqip(tar)e paraqitet edhe një letërsi shqipe e shkruar me alfabet arab, e cila, bashkë me dy pjesët e mëparshme të letërsisë kombëtare, duke u larguar nga botëpërjetimi i theksuar ideologjik fetar dhe duke futur tema të jetës sociale, paraqet hallkën e ndërldhjes së një letërsie, ku afirmimi i kombëtares ishte dytësor në një letërsi, e cila afirmimin e vetëdijes kombëtare e nxjerr në plan të parë, si është letërsia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Cilët janë këta faktorë letrarë që letërsinë evropërendimore, të kësaj periudhe, që i bashkojnë nën një emërues të përbashkët? Përgjigja do të ishte: mbështetja në të arriturat e Humanizëm Renesancës – afirmimi i shkencave të natyrës, afirmimi i mendjen dhe i dinjitetit të njeriut; lufta kundër misticizmit mesjetar e barok; afirmimi i letërsisë dhe i filozofisë antike helene e romake. Me një fjalë përshkrimi i jetës së gjallë e të lirë të njeriut, përballë vdekjes, ndytësirës, errësirës në Barokun paraprak ose fatalizmin e tragjizmin në Romantizmin pasues.

Prandaj edhe këtë periudhë të letërsisë shqiptare duhet ta shohim si një hallkë ndërldhëse e shoqëruar të dy periudhave: asaj paraprake – humaniste dhe asaj pasuese të Rilindjes Kombëtare. Ajo, në periudhën e parë – të *Barokut letrar religjioz*, letërsia përgjithësisht i nënshtrohet **institucionit utilitar moralizues – religjionit** dhe vetëm në planin dytësor përjetimi estetik i shërben qëllimit artistik; njësoj si edhe në

periudhën e dytë – të *Klasicizëm Iluminizmit*, kur është përpjekur që këto dy pozita t'i për afrojnë e njëjtësojë dhe ta bëjë hapin e parë drejt shmangies së institucionalizimit utilitar ideologjik, por jo me ndonjë sukses të madh: kjo letërsi edhe pse i shmanget angazhimit utilitar moralizues fetar, asaj, si e trashëguar nga e kaluara, i mbetet mbitheksimi i angazhimit **didaktik mësimor universal**. Pikëpamje kjo, e cila akoma edhe sot është e gjallë në disa mjedise shkencore dhe në një pjesë të madhe të studimeve teorike letrare shqiptare.

Dhe jo vetëm kaq, ky lloj angazhimi di të jetë i mbitheksuar në tejskajshmëri, sikurse ngjet me pjesën më të madhe të *librave të leximit*, ku tekstet letrare nuk shërbejnë për përfitimin e njohurive nga dija e letërsisë dhe për ngritjen e vetëdijes letrare, por për përmbushjen e parimeve pedagogjike – didaktike – psikologjike (sidomos ato të shkollave të ciklit të parë deri te shkollimi i mesëm). Nëpër këto libra leximi njohuritë për letërsinë jepen shumë shkurtimisht dhe tepër sipërfaqësisht, sa që, në vëllimin e orës mësimore, nuk kapin as një të dhjetën e orës mësimore, përkundër njohurive pedagogjike – didaktike që tejkalojnë 90 % të pjesëve letrare të dhëna si ilustrim. Këto lloje librash mund të quhen se janë gjithçka tjetër dhe shërbejnë për plotësimin e këtyre apo të atyre kërkesave metodike (didaktike – moralizuese, pedagogjike – psikologjike), por për libra të mësimi të letërsisë ose të dijes për të në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen.

Shumë më keq qëndron puna me *librat e letërsisë për shkollat e mesme*. Te këto libra, për dallim nga të parat, në vend të didaktizimit është i theksuar **biografizmi**– jeta biologjike e shkrimtarit. Fëmijët tanë kështu mësojnë lloj– lloj aventurash të shkrimtarëve, sidomos në pjesët e interpretimit të veprave letrare e të personazheve të tyre, jeta e të cilëve në veprën letrare identifikohet me jetëshkrimin e autorit dhe jeta e personazhit jepet si pjesë përbërëse e jetës shkrimtarit (vetëm një shembull: Rina dhe Serafina nga personazhe dalin dashnore të De Radës).

## 7. Letërsia shqiptare pjesë përbërëse e letërsisë evropiane

Letërsia shqipe, kështu, në kontekst më të gjerë, nuk bën përjashtim nga letërsitë e tjera evropereëndimore, nuk është oazë e izoluar, por është pjesë përbërëse e saj. Ajo është bashkëkohëse dhe bashkudhëtare me to dhe ndjek proceset letrare njësoj si dhe ato. Me veçoritë e veta dalluese, me prurjet e reja që sjell në truallin letrar kombëtar pasuron dhe begaton jo vetëm fondin e vet kombëtar, por duke qenë pjesë përbërëse e kontinentit, jep ndihmesën vetjake për pasurimin dhe begatimin e letërsisë botërore edhe në rrafshin përshkrimor tematik dhe sidomos në atë gjuhësor e zhanror, duke e pasuruar me zhanre e lloje të reja letrare.

### Bibliografi:

- x x x (1959), Historia e letërsisë shqipe I, Tiranë.  
 x x x (1983, 1989), Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë, Prishtinë.  
 x x x (1973, 1985), Historia e letërsisë shqiptare 1, për shkollat e mesme të përgjithshme, Tiranë. Deri më 1990 do të përfutojë disa ribotime.  
 x x x (1941), Shkrimtarët shqiptarë, Pjesa I. (1462-1878). Mbledhë e redaktue na Namik Ressuli, Tiranë.  
 Ani], Vladimir (2003): Veliki rje]nik hrvatskog jezika. Zagreb: Novi Liber.  
 Biti, Vladimir (1997): Pojmovnik suvremene književne teorije. Zagreb: Matica hrvatska.  
 Çabej, Eqrem (1936), Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe, me pjesë të zgjedhura për shkollat e me–s–me, Tiranë.  
 Curtius, Ernst Robert (1971), Evropska knjizhevnost i latinsko srednjovjekovlje, Zagreb.  
 Flaker, Aleksandar (1977), Stilske formacije, Liber, Zagreb.  
 Hamiti, Sabri (1989), Vetëdija letrare. (Sprova për një Poetikë) 4, Rilindja, Prishtinë.  
 Hysa, Mahmud (2000), Hyrje në letërsinë shqipe, Prishtinë.  
 Ismajli, Rexhep (2000), Tekste të vjetra, Prishtinë.  
 Jaus, Hans Robert (1970), Teorija rodova i knjizhevnost srednjega vijeka, »Umjetnost rijeji«, Zagreb, 14/1970, 3, 327 – 352;



Martini, Friz (1978), Istorija nema]ke knjizhevnosti, Nolit, Beograd.

Rugova, Ibrahim (1982), Vepra e Bogdanit. Rilindja, Prishtinë.

Slamnig, Ivan (1973), Svjetska knjizhevnost zapadnoga kruga. Zagreb.

Solar, Milivoj (2003): Povijest svjetske knjizhevnosti. Zagreb: Golden marketing.

Stavileci, Masar (1990), Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Prishtinë.

Shuteriqi, Dhimitër S. (2005), Shkrimet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879 – 1800, Tiranë.

Uçi, Alfred (2004), Filozofia e Teodor Aanas Kavaliotit, Tiranë.

Xhiku, Ali (2003), Duke lexuar letërsinë e traditës, Dituria, Tiranë: 12 – 22; 23 – 41; 47 – 50..